




KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVO		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Data e miratimit: 16. 12. 2025.		
Nr.:	Nr. B/:	Shtojcë - Prilog:
15-300/01-0080396/25.		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK



DITËT E FUNDVITIT 2025

QËLLIMI

Projekti ka synim që me rastin e fluksit të ardhjes së mërgimtarëve gjatë sezonës së dimrit, të rrisë gamën e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për qytetaret e Komunës, përmes vendosjes së gjashtë (6) shtëpizave të drurit në sheshin "Ali Ajeti" dhe "Zahir Pajaziti" në Podujevë:

- Dy (3) Shtëpiza do të ofrohen në shërbim të gastronomisë në sheshin "Zahir Pajaziti" dhe
- Tri (3) Shtëpiza do të ofrohen në shërbim për Biznese/Ojq në prodhim, përpunim të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme në sheshin "Ali Ajeti".

RREGULLAT

1) Vendi dhe orari i punës

Hapja e festivalit bëhet me datën 22.12.2025 dhe do të qëndroj hapur deri më datën 16.01.2026.

Gjatë kësaj kohe Bizneset/Ojq-të e përzgjedhura për shtëpiza lejohen të punojnë çdo ditë nga e hëna në të dielën.

2) Kriteret e aplikimit

Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e Bizneseve /Ojq-ve të jetë sa më adekuate:

- Bizneset/Ojq-të aplikuese duhet të jenë të regjistruara dhe të kenë aktivitet primar fushën e gastronomisë, si dhe Ojq-të në prodhim, përpunim të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme.
- Bizneset/Ojq-të aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikujt që do t'i ofrojnë, çmimore e cila do të jetë në fuqi deri në mbyllje të festivalit.
- Aplikuesit për shtëpiza që do të ofrohen në shërbim për Biznese/Ojq në prodhim, përpunim të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme duhet të dorzojnë së paku dy (2) mostra dhe mënyrë e produkteve (Aplikacionet pa përmbajtjen e këtyre mostrave nuk do të shqyrtohen)
- Të drejtë aplikimi kanë vetëm Bizneset/Ojq-të lokale

3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

Përzgjedhja e Bizneseve/Ojq-ve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në këtë aktivitet do të bëhet nga komisioni i përcaktuar nga Komuna e Podujevës.

- Bizneset/Ojq-të të cilat promovojnë dhe shërbejnë produktet vendore;
- Bizneset/Ojq-të që ofrojnë produkte konsumi inovative (të reja) në fushën e gastronomisë dhe në prodhim, përpunim të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme, produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së dimrit (këtu nuk përfshihen produktet e skarës dhe kuzhinës në përgjithësi);
- Bizneset/Ojq-të që ofrojnë dëshmi për punëtorët e deklaruar në ATK;
- Përparësi në përzgjedhje kanë mikro bizneset;
- Përparësi Bizneset/Ojq-të të cilat udhëhiqen nga gratë (femrat);

4) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë

- Komuna e Podujevës gjatë ditëve të festivalit ndalon rreptësisht kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme mbrenda zonave të zhvillimit të festivalit; abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë bizneset shitëse/konkuruese si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtarë;
- Ndalohet përdorimi i skarës dhe përgaditja e ushqimeve nga kuzhina përgjithësisht.
- Obligohen të gjitha Bizneset-Ojq-të e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës të pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën përreth tyre;
- Të gjitha Bizneset/Ojq-të duhet t'u përmbahen obligimeve që dalin nga kontrata me Komunen e Podujevës për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit.
- Bizneset përfituese të gjitha shërbimet gastronomike duhet t'i ofrojnë/shërbejnë në ambalazh një përdorimshe, material nga letra ose plastika. (Ndalohet përdorimi i shisheve dhe gotave nga qelqi);
- Bizneseve/Ojq-të e përzgjedhura do t'u lejohen vetëm 4 banake para shtëpizave të tyre;
- Bizneset/Ojq-të e përzgjedhura do ta kenë obligative që afër shtëpizës ta kenë shportën për mbeturina.
- Bizneset/Ojq-të aplikuese duhet të jenë të pajisura me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Festivalin Dimror;
- Energjia elektrike nuk lejohet të përdoret për ngrohje apo qëllime tjera, por vetëm për përgatitjen e produkteve të konsumit.
- Aplikuesit e përzgjedhur janë të obliguar t'i dekorojnë shtëpizat në bazë të dekorit të përcaktuar nga Komuna e Podujevës, pasi që të gjitha shtëpizat duhet të kenë pamje të njëjtë;
- Të gjitha Bizneset/Ojq-të janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre, në mënyrë që ky bashkëpunim të jetë sa më mirë.
- Bizneset e përzgjedhura obligohen të marrin përsiper shpenzimet e energjisë elektrike, pagesa bëhet përmes ndarjes proporcionale të borxhit total në momentin që paguhet fatura totale e shfrytëzimit të hapsirës.

5) Mënyra e aplikimit

- Aplikuesit kanë të drejtë aplikimi vetëm një herë me Qertifikatën e biznesit/OJQ-së. Me rastin e aplikimit, kërkohet kopja e letërnjoftimit.
- Oferta dorëzohet sipas formave standarde që Bizneset/Ojq-të përdorin në veprimtaritë e tyre.
- Aplikuesit në aplikim duhet t'i bashkangjesin dokumentet përcjellëse: kopjet e çertifikatës së regjistrimit të Biznesit/Ojq-së dhe numrin fiskal.
- Afati për aplikim: 16.12.2025 deri më 18.12.2025 prej orës 08:00 - 16:00 | Komuna e Podujevës – zyra pritëse e Komunës.
- Të përzgjedhurit do të njoftohen se kur duhet të paraqiten në objektin e Komunës së Podujevës për nënshkrimin e kontratës, dhe procedurat e më tutjeshme.

VËREJTJE

- Komuna e Podujevës nuk merr përsipër përgjegjësinë dhe obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës rreth arkës fiskale, andaj obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që kuponët fiskal t'i vërtetojnë (vulosin) në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Nëse nuk zbatohet kodi i mirësjelljes i sqaruar më lartë, Bizneset/Ojq-të do të sanksionohen me shkëputjen e kontratës për shtëpizë dhe në të ardhmen nuk do të mund t'i shfrytëzojnë këto shtëpiza.
- Çdo Biznes/Ojq përfitues për shfrytëzimin e shtëpizës është i obliguar që veprimtarinë ta ushtroj vetë e jo ta bartë te palët e treta.
- Te tre (3) Shtëpiza që do të ofrohen në shërbim për Biznese/Ojq (gra) në prodhim, përpunim të prodhimeve bujqësore dhe artizanate, varësisht nga numri i aplikacioneve/kërkesave, komisioni mund të vendosë që dhënia në shfrytëzim të bëhet me rotacion.



Drejtori i DPZHE:

z. Vigan Salihu